

**UDHËZIMI**

Nr. 25, datë 18.10/2022

**Mbi modalitetet dhe afatet për pjesëmarrjen e simpatizantëve në Primaret e Partisë  
Demokratike për pushtetin vendor**

Në bazë të Vendimit nr 38 të Këshillit Kombëtar, datë 01.10.2022, "Për miratimin e rregullores mbi modalitetet e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet për pushtetin vendor", mbështetur në nenet 25 dhe 27 të statutit të PDSH.Kryesia e Partisë Demokratike,

**VENDOSI**

1. Nisjen e procesit të regjistrimit të simpatizantëve të Partisë Demokratike, në të gjitha degët e Partisë Demokratike, të cilët duan të regjistrohen si votues në Primaret e Partisë Demokratike për zgjedhjet vendore 2023;
2. Kryetari i seksionit në bashkërendim me seksionin dhe Kryetarin e Grupseksionit, në përputhje me nenin 25 dhe 27 të statutit, bën regjistrimin e simpatizantëve sipas Qëndrave të Votimit në Degën (bashkinë) ku voton, duke plotësuar formularin personal të simpatizantit sipas shtojcës 1. Simpatizanti mban kundrabletën e regjistrimit e cila është e vlefshme deri në momentin e pajisjes me kartën e simpatizantit.
3. Simpatizanti regjistrohet duke plotësuar në mënyrë korrekte të dhënat e kërkuara në formularin e simpatizantit. Plotësimi i formularit të simpatizantit me të dhëna jo të sakta mund të sjellë mospasqyrimin e emrit të tij në listën e votuesve;
4. Në të njëjtën kohë Degët, në nivel seksioni dhe grupseksioni, luajnë një rol aktiv në përditësimin e regjistrit të simpatizantëve. Bazuar në të dhënat historike të degës për profilizimin e votuesve, seksionet dhe grupseksionet e degës marrin kontakt dhe i ftojnë të gjithë simpatizantët si dhe votuesit potencialë të PDSH-së, të regjistrohen në Primare;

5. Degët e Partisë Demokratike marrin të gjitha masat logjistike për regjistrimin e simpatizantëve. Konkretisht, degët sigurohen që simpatizantët dhe votuesit potencialë të cilët janë banorë të territorit të degës:
  - a. Të jenë kontaktuar të gjithë me ftesën për tu bërë pjesë e procesit zgjedhor të Primareve;
  - b. Të kenë informacion e duhur se ku (në cilën adresë, vendndodhje fizike) dhe si (në cilën mënyrë), duhet aplikuar për të plotësuar formularin e simpatizantit;
  - c. Të kenë asistencën përkatëse gjatë plotësimit të formularit, nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë;
6. Degët hedhin të dhënat e regjistrimit të simpatizantëve në regjistër sipas shtojcës 2 dhe më pas i përcjellin ato, pa ndryshim, në Qendër. Degët raportojnë çdo ditë për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit të simpatizantëve dhe dërgojnë në format elektronik shtojcën 2, të plotësuar, pranë Sekretariatit Organizativ dhe të Burimeve Njerëzore të PDSH ([pd@rithemelimi.com](mailto:pd@rithemelimi.com));
7. Sekretariati Organizativ dhe i Burimeve Njerëzore, në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me degët, ndërton dhe përditëson regjistrin e simpatizantëve sipas degëve, së bashku me të gjitha informacionet përkatëse shoqëruese të këtij regjistri. Për të mundësuar finalizimin e regjistrimit të simpatizantëve për çdo degë, regjistrimi i simpatizantëve ndërpritet **5 ditë** përpara datës së shpallur së Primareve;
8. Degët e Partisë Demokratike marrin masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të simpatizantëve, duke administruar regjistrin e simpatizantëve me të njëjtat rregulla dhe procedura me të cilat administrohet regjistri i anëtarësisë së degës;
9. Ngarkohet Sekretariati Organizativ dhe i Burimeve Njerëzore dhe Degët e Partisë Demokratike, për zbatimin e këtij vendimi;
10. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flamur Noka



**FORMULAR I REGJISTRIMIT TË SIMPATIZANTIT**

Data /\_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

Dega \_\_\_\_\_,

Bashkia \_\_\_\_\_,

QV \_\_\_\_\_

Emër \_\_\_\_\_

Mbiemër \_\_\_\_\_

Atësi \_\_\_\_\_

Ditëlindje Datë \_\_\_\_ / Muaj \_\_\_\_ / Viti \_\_\_\_\_

Celular \_\_\_\_\_

Email \_\_\_\_\_

Nr Personal (ID) \_\_\_\_\_

*(Leternjoftim ID: fillon me shkronjë, pasohet nga 8 numra dhe përfundon me shkronjë)*

**Kryetari i seksionit**

Emër Mbiemër, Nënshkrimi

Nr serie: xxxxxxxx

**Simpatizanti**

Emër Mbiemër Nënshkrimi

Data /\_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

**Kryetari i seksionit**

Emër Mbiemër, Nënshkrimi

Nr serie: xxxxxxxx

**Simpatizanti**

Emër Mbiemër Nënshkrimi

## REGJISTRI I SIMPATIZANTËVE

Dega \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_

Data e raportimit: \_\_ / \_\_ / \_\_\_\_

nr	QV	Emër	Mbiemër	Atësi	Ditëlindje Dita/muaj/vit	Cel	Nr Personal ID
1							
2							
3							
4							
5							
6							

**Shënim:**

Ky format në Exel do të dërgohet me email çdo ditë pranë Sekretariatit Organizativ, në adresën: [pd@rithemelimi.com](mailto:pd@rithemelimi.com)